



# ADMINISTRATA PUBLIKE DERI NË VITIN 2020




## PËR NJË ADMINISTRATË TË BAZUAR NË MERITA



Punësimi dhe avancimi në administratë deri në vitin 2020, duhet të jetë sa më shumë i bazuar në aftësi dhe rezultate.

Objektivat kryesore në këtë fushë janë:

**PËRMIRËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE TË DREJTUESËVE TË ORGANEVE DHE STAFIT TË LARTË MENAXHUES, ME KRITERE TË PËRCAKTUARA QARTË PËR ZGJEDHJEN E TYRE**



Kufiri ndërmjet politikës partiake dhe administratës publike duhet të jetë sa më i qartë. Ky kufi shpeshherë është i paqartë e që i shkojnë në favor edhe kriteret e ulëta të përzgjedhjes së drejtuesve të lartë (p.sh. drejtorët e përgjithshëm dhe sekretarët në ministri). Kjo situatë duhet të ndryshojë deri në vitin 2020.

## RITJA E KONKURENCËS DHE ZVOGËLIMI I ARBITRARITETIT NË PUNËSIM

Edhe pse shumica e qytetarëve duan një punë në administratë, plotësimi i vendeve të punës nuk ka konkurrencë të mjaftueshme. Këmbëngulja e eporëve të organeve është ende e lartë në punësim. Qeveria premtoi se do të ndërmarrë hapa që kjo dukuri të zvogëlohet, para së gjithash përmes transparencës më të madhe dhe numrit më të reduktuar të kandidatëve në listë për zgjedhje. Kjo do të jetë një bazë e rëndësishme për marrjen e vendimeve në punësimin e kuadrove.



**PËRMIRËSIMI I MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE KRIJIMI I NJË SISTEMI EFEKTIV PËR MONITORIMIN DHE PËRSHTATJEN E NUMRIT TË PUNONJËSVE SI DHE MATJEN E CILËSISË SË PUNËS SË TYRE**

Shpesh na rastis të dëgjojmë se administrata jonë është masive. Qeveria ka premtuar se deri në vitin 2020 do të reduktojë për 5% numrin e të punësuarve në organet shtetërore, në organizatat, ndërmarrjet dhe institucionet publike në nivel shtetëror.

